Kronikë

Fier/ Tentuan të vrisnin nënë e bir, në pranga 66-vjeçari, në kërkim djali

Është arrestuar 66-vjeçari i cili një ditë më parë së bashku me djalin tentuan të vrisnin nënë e bir teksa po lëviznin me motor në Fier. Dyshohet se mes familjeve Mërnica dhe Cimili ka ndodhur një konflikt pronësie 6 muaj më parë.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
10 Prill, 08:39 | **Përditësimi: 10 Prill, 12:28**

Share

FIER-Është arrestuar 66-vjeçari i cili një ditë më parë së bashku me djalin tentuan të vrisnin nënë e bir teksa po lëviznin me motor në Fier. Ndërkohë vijon puna për kapjen e 23-vjeçarit.

Blutë e Fierit bëjnë me dije se kanë sekuestruar një makinë dhe tre celularë të autorëve.

Autorët Afrim dhe Ali Cimili u identifikuan pas dëshmisë së djalit të Suzana Mërnicës e cila u lëndua si pasojë e rënies nga motori.

LEXO EDHE:
Përurohet Parku Fotovoltaik i Karavastasë! 'Pavarësi' nga reshjet, Shqipëria prodhon 10% të energjisë nga dielli, PS kërkon ta çojë 30%

Ngjarja ndodhi në (9 prill) rreth orës 14:00, në segmentin rrugor Fier-Seman, në degën që lidh këtë aks me rrugën drejt fshatrave Sulaj dhe Hamil. Suzana Mërnica ishte në motomjet, të cilin e drejtonte i biri, duke u kthyer në shtëpinë e tyre në fshatin Sulaj.

Dyshohet se mes familjeve Mërnica dhe Cimili ka ndodhur një konflikt pronësie 6 muaj më parë.

Sipas hetimeve, ka qenë ***tentativë e pastër për vrasje***, por plumbat nuk goditën objektivin dhe gruaja plagët i ka marrë pas rënies nga motori.

Njoftimi i policisë

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Kundër Personit, menjëherë pas ngjarjes së ndodhur më datë 09.04.2025, te mbikalimi i fshatit Dërmenas, ku shtetasit A. C., 66 vjeç dhe A. C., 23 vjeç, babë e bir, të dy banues në këtë fshat, dëmtuan shtetasit H. M., 26 vjeç dhe S. M., 50 vjeçe, nënë e bir, të dy banues në fshatin Sulaj, kanë organizuar punën për nxjerrjen e autorëve përpara përgjegjësisë penale dhe për sqarimin e rrethanave të rastit.

Si rezultat i veprimeve të shpejta dhe profesionale hetimore u zbardh dinamika e rastit, si dhe u kap dhe u vu në pranga 66-vjeçari.

Nga këto veprime dyshohet se shtetasit A. C. dhe A. C., për shkak të një konflikti të mëparshëm ndërmjet 23-vjeçarit dhe 26-vjeçarit, kanë qëlluar me armë zjarri, në drejtim të motomjetit me të cilin lëviznin shtetasit H. M. dhe S. M.. Nga të shtënat nuk pati shtetas të dëmtuar. Më pas, 23-vjeçari ka goditur me automjetin me të cilin lëvizte, motomjetin, dhe është larguar nga vendngjarja, së bashku me babanë e tij. Si pasojë e goditjes së motomjetit, janë dëmtuar shtetasit H. M. dhe S. M., të cilët janë në kujdesin e mjekëve dhe jashtë rrezikut për jetën.

Në vendngjarje janë sekuestruar gëzhoja dhe prova që do t'i shërbejnë hetimit për këtë ngjarje. Gjithashtu, janë sekuestruar njëri prej automjeteve të përdorur prej autorëve dhe 3 celularë.

Vijojnë kërkimet për kapjen e 23-vjeçarit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtjeshme, për veprat penale "Vrasja me paramendim", mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe municionit luftarak".

Xh.K/I.M/Shqiptarja.com

TAG: Fier | Suzana Mërnica | Afrim Cimili | Ali Cimili

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Nis fushata zgjedhore për 11 majin, si e parashikoni?
11 Prill, 07:13

Të qetë | Të tensionuar | Nuk e di

Lajme të tjera

VIDEO bëri xhiron e rrjetit, 'zhduket' luani në Fier! Pronari me precedent penal: E gjeta në rrugë në Lushnjë dhe më ngordhi! Hetohet në gjendje të lirë
10 Prill, 11:27

Mallakastër/ Fshati Belishovë i pasur në naftë, i varfër në infrastrukturë, 40 vite pa investime në rrugë
Marsela Topi
9 Prill, 15:37

Ulja e temperaturave dëmton mbi 400 hektarë patate në Divjakë, fermerët: Dëmi i madh, nuk do marrin dot as lekët e farës
Yrjet Saliasi
9 Prill, 15:26

Atentat i dështuar në Fier/ Qëllohet me armë drejt një motori, plagoset pas rënies nëna e drejtuesit! Në kërkim babë e bir (EMRI+VIDEO)
9 Prill, 14:33

Përplasja me armë mes dy vëllezërve në Divjakë/ Shkak dyshohet një konflikt pronësie, arrestohet njëri prej tyre! Nën hetim edhe një 57-vjeçar
Yrjet Saliasi
9 Prill, 08:23

Sherr mes dy vëllezërve në Fier-Seman/ Njëri qëllon me armë ndaj tjetrit, autori largohet në drejtim të paditur bashkë shokun e tij (VIDEO)
8 Prill, 21:09



Trafikuan vepra arti, Prokuroria e Fierit çon për gjykim dy persona, sekuestrohen armë të shekullit të XVIII-XIX dhe ikona
8 Prill, 13:22

'.Jemi në luftë për të mbijetuar', Bardhi me qytetarët në Patos: Të kthejmë shpresën dhe rininë
8 Prill, 11:23

Lulështrydhja greke me pesticide 'djeg' fermerët vendas: Po penalizohemi padrejtësisht! Shteti të bëjë analizat! Derdhin arkat në rrugë (VIDEO)
Marsela Topi
7 Prill, 16:38

Zgjedhjet/ Bardhi nga Cakrani: Nuk mund të vazhdohet më kështu pas 12 vitesh, këtë s'e thonë vetëm demokratët
6 Prill, 10:06

Zgjedhjet/ Gazment Bardhi akuzon zv/kryeministrin nga Fieri: Belinda Balluku na fiku dritat gjatë takimit në Divjakë! (VIDEO)
5 Prill, 21:26

Një festival për promovimin e traditës rome/ Për herë të parë në Roskovec vjen 'Roma Romale 2025'
5 Prill, 10:26

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje